



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
APELACIONI SUD KOSOVO – COURT OF APPEALS

---

Ac.nr.1004/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, S.S nga Prishtina, kundër debitorit, Qendra Klinike Universitare e Kosovës –QKUK, me seli në Prishtinë, për pagesën e borxhit në shumë prej 1,305.21 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1063/20, i datës 25.10.2020, me datë 26.05.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës – QKUK, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.1063/20, i datës 25.10.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.1063/20 i datës 25.10.2020 e ka hedhur poshtë si të pas afatshëm prapësimin e debitorit Qendra Klinike Universitare e Kosovës me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor, P.nr.203/2020, i datës 27.07.2020 i lejuar nga përmbartuesi privat, I.I.K, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës përmbartuese, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur propozim për përmbartim pranë organit përmbartues me datë 27.07.2020.

Përmbareuesi privat me urdhrin, P.nr.203/20, i datës 27.07.2020 ka lejuar përmbarimin.

Debitori në afatin ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin të organit përmbareues me propozim që të aprovet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.1063/20, i datës 25.10.2020 ka hedhur poshtë prapësimin si të pas afatshëm, duke vendosur më saktësisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me shikimin e shkresave të lëndës ka vërtetuar se debitori urdhrin përmbarimor e ka pranuar me datë 03.08.2020, çka vërtetohet përmes fletë-kthesës pjesë e dosjes së lëndës, ndërsa kundër urdhrin të përmbareuesit privat ka paraqitur prapësim, të cilin e ka dorëzuar direkt në zyrën e përmbareuesit privat me datë 11.08.2020, çka vërtetohet edhe në bazë të vulës së protokollit të përmbareuesit privat. Gjykata ka theksuar se nga shkresat e lëndës nuk ka ndonjë dëshmi që tregon se debitori e ka dorëzuar prapësimin përmes postës së regjistruar.

Tutje Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se meqenëse afati për paraqitjen e prapësimin është 7 ditë nga dita e pranimit të urdhrin përmbarimor, atëherë rezulton se prapësimi është dorëzuar pas skadimit të afatit prej 7 ditësh, pra është paraqitur 1 ditë me vonë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtari i Gjykatës së Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Debitori në ankesën e parashtruar pretendon se e ka paraqitur prapësimin e tij brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe se nuk mund të qëndroj konstatimi i Gjykatës se prapësimi është paraqitur më vonë dhe se përmbareuesi privat ka qenë i obliguar që të bashkëngjese fletë-dërgesën e postës si dëshmi se kur e ka pranuar prapësimin në mënyrë që të dokumentoj se prapësimi është ushtruar jashtë afatit. Sipas debitorit Gjykata e shkallës së parë nuk ka cekur se në cilat prova është bazuar kur ka konstatuar se prapësimi është ushtruar jashtë afatit ligjor.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit erdhi në përfundim se të njëjtat janë të pa themelta, për arsye se prapësimi i paraqitur është i pa afatshëm, kështu që edhe kjo Gjykatë e konsideron vendimin e Gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjatë shikimit të shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit vëren se debitorit i është dërguar urdhri për përmbarim përmes Organit Përmbareues, e këtë fakt kjo Gjykatë e ka vërtetuar nga fletë-kthesa e përmbareuesit privat, ku me të njëjtën rezulton të vërtetohet se shkresën e ka pranuar debitori, në emër të Qeveria e Kosovës –Ministria e Shëndetësisë QKUK –Prishtinë. Përveç kësaj në fletë-kthesë është konstatuar se debitori urdhrin për përmbarim e ka pranuar me datë 03.08.2020.

Gjykata ankimore vëren se në shkresat e lëndës, më konkretisht në prapësimin e dorëzuar janë të vendosura dy vula ajo e debitorit kur është vendosur numri i protokollit, nr.6409/2, i datës 07.08.2020 si dhe më poshtë vula e Organit përmbareues, me datë 11.08.2020, nr.554/20.

Debitori pretendon se prapësimi është dorëzuar me datën sikurse në vulën e vulosur nga debitori, mirëpo kjo Gjykatë këtë pretendim nuk mund ta marrë si të bazuar për faktin se debitori nuk e vërtetuar këtë pretendim të tij me asnjë fakt. Gjykata duhet të marrë për bazë gjithmonë datën e pranimit të shkresës tek organi kompetent, pra organi përmbarues apo në raste të tjera Gjykatës, apo datën kur shkresa dorëzohet në Postë, por jo edhe datën që e vendosë vetë debitori në shkresë.

Së bashku me ankesë, Gjykata e Apelit vëren se debitori ka bashkëngjitur një dëftesë për pranimin e dërgesës nga ana e debitorit tek organi përmbarues, e cila dëftesë korrespondon me datën e cila është vendosur nga debitori në prapësim, por që kjo Gjykatë nuk mund ta marrë këtë si provë për faktin se duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, më konkretisht nenin 180 të LPK-së, me ankesë nuk mund të paraqiten prova dhe fakte të reja, përveç nëse pala ofron prova se këto pa fajin e vet nuk i ka parashtruar.

Në rastin konkret debitori nuk e ka ofruar asnjë provë të vetme se për ndonjë shkak të arsyeshëm, dëftesa e postës nuk gjendet në shkresa të lëndës dhe se përmbaruesi privat nuk ia ka dorëzuar Gjykatës këtë dëftesë si dëshmi se prapësimi është paraqitur brenda afatit të caktuar.

Pra, Gjykata ankimore e mbështet në tërësi vendimin e Gjykatës së shkallës së parë me të cilin e ka hedhur prapësimin si të pasafatshëm, për arsye se debitori sipas provave të gjenden në shkresa të lëndës, afati i fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë me datë 10.08.2020 sepse nga fletë-kthesa e pranimit të urdhrit, rezulton se urdhrin e ka pranuar me datë 03.08.2020, ndërsa nga vula e pranimit tek organi përmbarues, prapësimi është paraqitur me datë 11.08.2020, pra ka paraqitur prapësimin pas afatit 7 ditore i cili është i përcaktuar në mënyrë decitive me nenin 70 të LPP-së, andaj si i tillë sipas dispozitave ligjore më saktësisht neni 73 par.3 të LPP-së, prapësimi duhet të hedhet poshtë si i pa afatshëm.

Debitori me asnjë provë nuk ka arritur që ti bëjë të besueshme pretendimet e tij në ankesë, andaj, Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet e kreditorit në ankesë janë të pa themelta, pasi në rastin konkret i njëjti nuk ka vepruar konform urdhrit të gjykatës, andaj, Gjykata nuk gjeti ndonjë arsye që të merr ndonjë vendim ndryshe prej atij sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1004/21, të datës 26.05.2022

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.